



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 146

Tiranë – E martë, 10 tetor 2023

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 70/2023, datë 14.9.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi për sigurimet shoqërore..... 16107
Dekret i Presidentit nr. 273, datë 4.10.2023	Për shpallje ligji..... 16115
Ligj nr. 71/2023, datë 14.9.2023	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjeshme të zgjeruar (EPA) për themelimin e regjistrit të dëmeve të shkaktuara nga agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës..... 16115
Dekret i Presidentit nr. 274, datë 4.10.2023	Për shpallje ligji..... 16123
Ligj nr. 75/2023, datë 14.9.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar..... 16123
Dekret i Presidentit nr. 275, datë 4.10.2023	Për shpallje ligji..... 16124
Dekret i Presidentit nr. 262, datë 3.10.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16124
Dekret i Presidentit nr. 263, datë 3.10.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16124
Dekret i Presidentit nr. 264, datë 3.10.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 16125
Dekret i Presidentit nr. 265, datë 3.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 16125
Dekret i Presidentit nr. 266, datë 3.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 16125

Dekret i Presidentit nr. 267, datë 3.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16126
Dekret i Presidentit nr. 268, datë 3.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16126
Dekret i Presidentit nr. 269, datë 3.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16126
Dekret i Presidentit nr. 270, datë 3.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16126
Dekret i Presidentit nr. 271, datë 3.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16127
Dekret i Presidentit nr. 272, datë 3.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16127
Dekret i Presidentit nr. 277, datë 5.10.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	16128
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 6.10.2023	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për përballimin e shpenzimeve të organizimit në Tiranë të Samitit të Procesit të Berlinit, datë 16 tetor 2023.....	16128
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 315, datë 13.9.2023	Për delegim kompetencash.....	16128
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 316, datë 13.9.2023	Për delegim kompetence.....	16129
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 317, datë 13.9.2023	Për delegimin e kompetencës së përfaqësimit ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore.....	16129
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 581, datë 28.9.2023	Për heqjen e licencës së shoqatës “F.M.A.A.” si Agjenci e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale.....	16130
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 115, datë 30.3.2023	Mbi miratimin e një ndryshimi në “Kodin e rrjetit TAP” propozuar nga TAP AG.....	16132

**LIGJ**  
**Nr. 70/2023****PJESA I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES**  
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË DHE MALIT TË ZI PËR**  
**SIGURIMET SHOQËRORE****Neni 1**  
**Përkufizime**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:****Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi për sigurimet shoqërore sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.9.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 273 datë 4.10.2023,**  
**të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bajram Begaj.**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**DHE MALIT TË ZI**  
**PËR SIGURIMET SHOQËRORE**

Republika e Shqipërisë dhe Mali i Zi (në vijim të referuara si “Shtetet Kontraktuese”), të cilat dëshirojnë të rregullojnë dhe zhvillojnë marrëdhëniet e tyre në fushën e sigurimeve shoqërore, bien dakord si më poshtë:

(1) Termat dhe frazat e përdorur në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

1. “territor”:

- për sa i përket Republikës së Shqipërisë: territori shtetëror i Republikës së Shqipërisë;

- për sa i përket Malit të Zi: territori shtetëror i Malit të Zi;

2. “shtetas i një Shteti Kontraktues”:

- për sa i përket Republikës së Shqipërisë: një person me nënshtetësi të Republikës së Shqipërisë;

- për sa i përket Malit të Zi: një person me nënshtetësi të Malit të Zi;

3. “legjislacion”:

ligjet dhe rregulloret e tjera sipas të cilave rregullohen fushat e përmendura në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;

4. “autoritet kompetent”:

ministrinë përgjegjëse për fushat që rregullohen nga legjislacioni i përmendur në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;

5. “institucion”:

organizata dhe/ose autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të përmendur në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;

6. “institucion kompetent”:

institucioni në të cilin personi ka qenë i siguruar në momentin e depozitimit të aplikimit për përfitime, ose nga i cili atij personi i buron, ose do t’i kishte buruar e drejta e përfitimeve, ose një institucion i caktuar nga Autoriteti Kompetent;

7. “person i siguruar”:

personi që është objekt ose ka qenë objekt i legjislacionit të përmendur në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;

8. “periudhë sigurim”:

periudha gjatë së cilës janë paguar kontributet e sigurimit dhe periudhat e barasvlershme të plotësuar sipas legjislacionit të secilit Shtet Kontraktues;

9. “përfitim”:

përfitim në para dhe përfitim në natyrë;

10. “përfitim në para”:

pension, kompensimi monetar dhe përfitimet e tjera në para, duke përfshirë të gjitha rritjet, pagesat e rivlerësuar ose pagesat suplementare;

11. “përfitim në natyrë”:

shërbime të kujdesit shëndetësor dhe përfitime të tjera, me përjashtim të përfitimeve në para;

12. “rezidencë”:

vendbanimi i përhershëm;



13. “vendqëndrim”: vendbanimi i përkohshëm;

14. “anëtarët e familjes”: personat e përcaktuar si të tillë sipas legjislacionit të Shtetit Kontraktues legjislacioni i të cilit zbatohet;

15. “organ ndërlidhës”: një organ i caktuar për zbatimin më efektiv të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Terma të tjerë që përdoren në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin që i është caktuar përkatësisht në përputhje me legjislacionin e secilit Shtet Kontraktues.

#### Neni 2

##### Objekti material i Marrëveshjes

(1) Kjo Marrëveshje do të zbatohet:

- Për sa i përket Republikës së Shqipërisë, lidhur me legjislacionin që rregullon:

1. pensionin e pleqërisë, pensionin e invaliditetit dhe atë familjar për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

2. përfitimet e sëmundjeve në para për personat e punësuar;

3. përfitimet e barrëlindjes në para për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

4. përfitimet në para lidhur me aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për personat e punësuar;

5. përfitimet në para në lidhje me përfitimet e papunësisë;

6. skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

-përfitime në natyrë sipas legjislacionit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

- Për sa i përket Malit të Zi, lidhur me legjislacionin që rregullon:

1. Sigurimin shëndetësor, mbrojtjen shëndetësore dhe barrëlindjen;

2. Sigurimin për pensionin e pleqërisë dhe të invaliditetit;

3. Sigurimin për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;

4. Përfitimet e papunësisë.

(2) Kjo Marrëveshje do t'i referohet edhe të gjitha dispozitave ligjore, të cilat përmbledhin, ndryshojnë ose plotësojnë dispozitat ligjore të përcaktuara në paragrafin (1).

#### Neni 3

##### Objekti personal i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për:

1. Personat që janë ose kanë qenë objekt i legjislacionit të njërit ose të të dyja Shteteve Kontraktuese.

2. Personat që përfitojnë të drejta nga personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

#### Neni 4

##### Trajtimi i barabartë

Përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, personat e përmendur në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime sipas legjislacionit të atij Shteti Kontraktues njëjloj si shtetasit e tij.

#### Neni 5

##### Eksportimi i përfitimeve

1) Përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, përfitimet në para nuk do të reduktohen, pezullohen ose tërhiqen për shkak se një person e ka rezidencën në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues.

2) Dispozitat e paragrafit 1 më sipër nuk do të zbatohen për përfitimet e mëposhtme:

1. Për sa i përket Republikës së Shqipërisë: përfitimet jokontributive;

2. Për sa i përket Malit të Zi: pensioni minimal, përfitimet e papunësisë dhe kompensimet për shpenzimet e funeralit.

#### PJESA II

##### DISPOZITA LIDHUR ME LEGJISLACIONIN E ZBATUESHËM

#### Neni 6

##### Dispozita të përgjithshme

Një person që ushtron një veprimtari si i/e vetëpunësuar në territorin e çdonjërit prej Shteteve Kontraktuese do t'i nënshtrohet legjislacionit vetëm të atij Shteti Kontraktues, edhe në rastet kur rezidenca e një punonjësi ose e një personi që ushtron një aktivitet si i vetëpunësuar ose vendi kryesor i biznesit të punëdhënësit ndodhet në territorin e një Shteti tjetër Kontraktues, nëse nuk



parashikohet ndryshe në dispozitat e neneve 7 dhe 8.

Neni 7

### **Dispozita të veçanta**

1. Nëse një punëdhënës i vendosur në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese transferon në detyrë një punonjës në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues, ky person do t'i nënshtrohet legjislacionit të Shtetit të parë Kontraktues, deri në skadimin e periudhës së përcaktuar në kontratë, në bazë së të cilës punonjësi është transferuar në detyrë dhe jo më shumë se 24 muaj, sikur të ishte i punësuar në territorin e tij/saj.

2. Nëse një person që ushtron një veprimtari si i vetëpunësuar në territorin e ndonjërit prej Shteteve Kontraktuese shkon në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues për kryerjen e përkohshme të asaj veprimtarie, ky person do t'i nënshtrohet legjislacionit të Shtetit të parë Kontraktues, për një periudhë jo më të gjatë se 24 muaj, sikur të kryente veprimtarinë e tij/saj në territorin e tij/saj.

3. Personat që janë anëtarë të personelit të udhëtimit ose fluturimit në shërbim të një punëdhënësi të angazhuar në fushën e transportit ajror, rrugor ose hekurudhor do t'i nënshtrohen legjislacionit të Shtetit Kontraktues ku është vendi kryesor i biznesit të punëdhënësit.

4. Anëtarët e ekuipazhit si dhe punëtorët e tjerë në anije do t'i nënshtrohen legjislacionit të Shtetit Kontraktues që mban flamurin e secilit prej dy Shteteve Kontraktuese.

5. Personat, të cilët kryejnë aktivitetet e ngarkimit, shkarkimit, riparimit, remontit ose mbikëqyrjes në portin e njërit prej Shteteve Kontraktuese të një anijeje që mban flamurin e një Shteti tjetër Kontraktues, do t'u nënshtrohen ligjeve të Shtetit Kontraktues të cilit i përket porti.

6. Nëpunësit civilë dhe personat e konsideruar si të tillë, personeli i shërbimit publik dhe përfaqësuesit zyrtarë që janë vendosur në detyrë në territorin e një Shteti tjetër Kontraktues do t'i nënshtrohen ligjeve të Shtetit Kontraktues që i ka dhënë atë pozicion në detyrë.

Neni 8

### **Misionet diplomatike dhe postet konsullore**

1. Personat e punësuar në misione diplomatike dhe poste konsullore, anëtarët e familjeve të tyre dhe

personat e punësuar për shërbime të brendshme të një anëtari të posteve në fjalë, të vendosur në territorin e një Shteti tjetër Kontraktues, do t'i nënshtrohen legjislacionit të Shtetit që i ka dhënë atë pozicion në detyrë.

2. Personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, të cilët nuk janë vendosur në detyrë, do t'i nënshtrohen legjislacionit të Shtetit Kontraktues ku ndodhet misioni diplomatik ose posti konsullor.

3. Personat e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, të cilët janë shtetas të zyrës diplomatike ose konsullore të Shtetit Kontraktues, mund të zgjedhin zbatimin e legjislacionit të Shtetit punëdhënës brenda tre muajve nga data e angazhimit të tyre ose pas hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

### **Përfjashtimet**

Me kërkesë të përbashkët të punëmarrësit dhe punëdhënësit të tij/saj, si dhe të personave që kryejnë një veprimtari si të vetëpunësuar, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të bien dakord për përfjashtimet nga dispozitat e neneve 6 deri në 8 të kësaj Marrëveshjeje.

## **PJESA III**

### **DISPOZITAT E VEÇANTA**

#### **Seksioni 1**

### **Përfitimet për shkak të sëmundjes dhe barrë lindjes**

Neni 10

### **Bashkimi i periudhave të sigurimit**

Nëse është e nevojshme, periudhat e sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të të dyja Shteteve Kontraktuese do të bashkohen për qëllime të përfitimit të së drejtës për përfitime dhe të përcaktimit të kohëzgjatjes së këtij përfitimi, për sa kohë që këto periudha nuk mbivendosen.

Neni 11

### **Përfitimet në natyrë**

1. Një person, i cili kualifikohet për një përfitim në natyrë sipas legjislacionit të një Shteti Kontraktues gëzon të drejtën për përfitime në natyrë



kur ai/ajo është rezident në një Shtet tjetër Kontraktues, në përputhje me legjislacionin e tij.

2. Një person, i cili kualifikohet për të ofruar përfitime në natyrë sipas legjislacionit të njërit prej Shteteve Kontraktuese gjatë qëndrimit të tij/saj në Shtetin tjetër Kontraktues gëzon të drejtën për trajtimin mjekësor urgjent të nevojshëm sipas gjendjes së tij/saj mjekësore, me kusht që qëndrimi të mos jetë realizuar për qëllime trajtimi.

3. Përfitimet sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni do të jepen në emër dhe për llogari të institucionit Kompetent nga institucioni sipas rezidencës së vendqëndrimit të personit, në përputhje me legjislacionin që zbaton institucioni.

4. Personat e përmendur në nenin 7, paragrafët 1, 2 dhe 5 dhe nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje gëzojnë të drejtën e përfitimeve në natyrë, në përputhje me legjislacionin e Shtetit Kontraktues ku janë vendosur në detyrë, me shpenzimet e mbuluara nga institucioni kompetent.

5. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përcaktojnë përfitime në natyrë, si proteza, pajisje dhe përfitime të tjera shëndetësore me kosto të larta për të cilat kërkohet dhënia e pëlqimit paraprak të autoritetit kompetent në rastin kur një person gëzon rezidencën ose vendqëndrimin, përveç nëse dhënia e përfitimeve të tilla duhet të jetë e menjëhershme.

6. Dispozitat e paragrafëve 1 deri në 5 të këtij neni do të zbatohen në mënyrë analoge për anëtarët e familjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi të secilit prej Shteteve Kontraktuese.

#### Neni 12

### **Përfitimet në natyrë për përfituesit e pensionit**

1. Një përfitues i pensionit të realizuar sipas legjislacionit të të dyja Shteteve Kontraktuese do t'i nënshtrohet ekskluzivisht legjislacionit të Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit ky përfitues i pensionit e ka rezidencën.

2. Përfituesi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të ketë të drejtë për përfitime në natyrë me shpenzimet e institucionit kompetent të Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit ka rezidencën përfituesi i pensionit.

3. Përfituesit e pensionit të përfituar sipas legjislacionit të njërit prej Shteteve Kontraktuese, të cilët kanë rezidencën në territorin e Shtetit tjetër

Kontraktues, do t'i nënshtrohen legjislacionit të atij Shteti Kontraktues dhe marrjes së përfitimeve në natyrë, sikur e drejta për pension të ishte të fituar në përputhje me legjislacionin e tij në fuqi dhe me shpenzimet e institucionit kompetent.

4. Në zbatim të paragrafit 3 të këtij neni, kur kushtet shëndetësore të pensionistit që është rezident në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese kërkojnë trajtim mjekësor urgjent gjatë qëndrimit të tij/saj në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues, ai/ajo gëzon të drejtën të marrë përfitime në përputhje me legjislacionin e Shtetit të dytë Kontraktues dhe me shpenzimet e Shtetit Kontraktues ku ai/ajo ka ushtruar të drejtën e pensionit.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 deri në 4 të këtij neni do të zbatohen në mënyrë analoge edhe për anëtarët e familjes së përfituesit të pensionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi të çdo Shteti Kontraktues.

#### Neni 13

### **Rimbursimi i shpenzimeve**

Institucioni kompetent do t'i rimbursojë shumën reale të shpenzimeve institucionit që ka ofruar përfitimet në natyrë, në përputhje me nenet 11 dhe 12 të kësaj Marrëveshjeje, përveç shpenzimeve administrative.

#### Neni 14

### **Përfitimet në para**

Përfitimet në para në rastet e paaftësisë së përkohshme për punë dhe barrë lindjes jepen dhe mbulohen nga institucioni kompetent në të cilin personi është i siguruar, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm përkatësisht.

#### Seksioni 2

### **Përfitimet në rastin e pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe familjar**

#### Neni 15

### **Bashkimi i periudhave të sigurimit**

1. Kur legjislacioni i ndonjërit prej Shteteve Kontraktuese e kushtëzon të drejtën për përfitime me plotësimin e periudhave të sigurimit, institucioni që zbaton atë legjislacion do të marrë parasysh, kur është e nevojshme, periudhat e sigurimit të



plotësuar sipas legjislacionit të Shtetit tjetër Kontraktues, për aq kohë sa ato nuk mbivendosen, sikur të ishin periudha sigurimi të plotësuar sipas legjislacionit të Shtetit të parë Kontraktues.

2. Kur një person nuk kualifikohet për një përfitim në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, institucionet kompetente do të bashkojnë gjithashtu periudhat e sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të një shteti të tretë me të cilin të paktën njëri prej Shteteve Kontraktuese ka lidhur një Marrëveshje për Sigurimet Shoqërore ku të parashikohet bashkimi i periudhave të sigurimit ose ka lidhur një kontratë përkatëse që parashikon bashkimin e periudhave të sigurimit.

3. Nëse legjislacioni i njërit prej Shteteve Kontraktuese e përcakton dhënien e përfitimeve në varësi të kushtit që periudhat e sigurimit të plotësohen në një profesion të caktuar, vetëm periudhat e sigurimit të plotësuar ose të njohura si të barasvlershme në të njëjtin profesion sipas legjislacionit të Shtetit tjetër Kontraktues do të mblidhen për t'u kualifikuar për të drejtën për këto pensione.

#### Neni 16

##### **Periudha e sigurimit prej më pak se një vit**

Kur kohëzgjatja totale e periudhave të sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit të Shtetit Kontraktues është më pak se një vit dhe kur në bazë të këtyre periudhave nuk ekziston asnjë e drejtë për përfitim, Autoriteti Kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues do të përfshijë ato periudha në mënyrë që të përcaktojë të drejtat dhe masën e përfitimeve sikur ato periudha sigurimi të ishin plotësuar sipas legjislacionit që ky autoritet zbaton.

#### Neni 17

##### **Përcaktimi i përfitimeve pa bashkimin e periudhave të sigurimit**

Nëse e drejta për përfitime sipas legjislacionit të secilit Shtet Kontraktues duhet të fitohet pa marrë parasysh dispozitat e nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje, institucioni kompetent i atij Shteti Kontraktues do të llogarisë përfitimet që duhet të jepen vetëm në bazë të periudhave të plotësuar sipas legjislacionit që zbaton.

#### Neni 18

##### **Llogaritja proporcionale (*pro rata*) e përkohshme e përfitimeve**

1. Nëse e drejta për përfitime sipas legjislacionit të secilit prej Shteteve Kontraktuese fitohet vetëm nëpërmjet zbatimit të dispozitave të nenit 15 të kësaj Marrëveshjeje, institucioni kompetent i atij Shteti Kontraktues do të llogarisë përfitimet si më poshtë:

- institucioni kompetent do të llogarisë shumën teorike duke marrë parasysh të gjitha periudhat e sigurimit të plotësuar sipas legjislacionit që zbaton. Shuma e përfitimit që nuk varet nga kohëzgjatja e periudhës së sigurimit do të konsiderohet si shumë teorike;

- në bazë të shumës së llogaritur siç përmendet më sipër, shuma aktuale e përfitimit do të llogaritet si proporcion ndërmjet periudhave të sigurimit të plotësuar ekskluzivisht sipas legjislacionit të tij dhe totalit të periudhave të sigurimit të marra në konsideratë për llogaritjen e përfitimit.

2. Kur përfitimet sipas legjislacionit të njërit prej Shteteve Kontraktuese llogariten në bazë të fitimeve, pagës, bazës së sigurimit dhe/ose kontributeve të paguara në një periudhë të caktuar, institucioni kompetent do të marrë parasysh të ardhurat, pagën, bazën e sigurimit dhe/ose kontributet e paguara vetëm në bazë të periudhave të plotësuar sipas legjislacionit që ky institucion zbaton.

#### Neni 19

##### **Reduktimi, ndryshimi, pezullimi dhe anulimi i përfitimeve**

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk mund të shkaktojë asnjë reduktim, ndryshim, pezullim dhe anulim të të gjitha përfitimeve takuese.

#### Seksioni 3

##### **Përfitimet për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale**

#### Neni 20

##### **Lëndimet gjatë udhëtimit për në punë dhe kthimit nga puna**

1. Një person me rezidencë në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese, i cili gjatë udhëtimit në punë për të hyrë në marrëdhënie pune, në bazë të



një kontratë pune, dhe/ose duke ushtruar një veprimtari si i/e vetëpunësuar në Shtetin tjetër Kontraktues, pëson një aksident, ai/ajo gëzon të drejtën për përfitime në bazë të aksidentit në punë, në përputhje me legjislacionin dhe me shpenzimet e institucionit kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues.

2. Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet edhe në rastin e aksidentit që një person pëson menjëherë pas skadimit të kontratës së punës dhe/ose me përfundimin e vetëpunësimit gjatë udhëtimit nga puna për në vendin e tij/saj të rezidencës.

#### Neni 21

##### **Përfitimet në natyrë**

1. Çdo person që ka të drejtë të marrë përfitime nga aksidenti në punë ose nga sëmundjet profesionale sipas legjislacionit të një Shteti Kontraktues dhe që e ka rezidencën ose vendqëndrimin në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues gëzon të drejtën për përfitime në natyrë me shpenzimet të institucionit kompetent në territorin e të cilit ai ka rezidencën ose vendqëndrimin, në bazë të legjislacionit që zbaton ai institucion.

2. Dispozitat e paragrafit 5 të nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen në mënyrë analoge për personin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

#### Neni 22

##### **Sëmundjet profesionale**

1. Kur, sipas legjislacionit të njërit prej Shteteve Kontraktuese, kualifikueshmëria për të marrë përfitime për shkak të sëmundjeve profesionale kushtëzohet nga fakti që sëmundja në fjalë të jetë shfaqur fillimisht në territorin e tij, ky kusht do të konsiderohet i përmbushur edhe kur sëmundja është shfaqur për herë të parë në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues.

2. Nëse dhënia e përfitimit në para në rastin e sëmundjes profesionale, sipas legjislacionit të një Shteti Kontraktues, kushtëzohet nga fakti që profesioni që mund të ketë shkaktuar këtë sëmundje ka zgjatur për një kohë të caktuar, institucioni kompetent i atij Shteti Kontraktues do të marrë gjithashtu parasysh, nëse është e nevojshme, periudhat e kaluara me këtë profesion ose në përputhje me legjislacionin e Shtetit tjetër Kontraktues.

#### Neni 23

##### **Përfitimet në para**

1. Përfitimet në para në rastin e aksidenteve në punë ose sëmundjeve profesionale do të paguhen nga institucioni i atij Shteti Kontraktues, legjislacioni i të cilit zbatohet për personin e siguruar në momentin e ndodhjes së aksidentit në punë dhe/ose herën e fundit të kryerjes së aktivitetit ekonomik që ka shkaktuar shfaqjen e sëmundjes profesionale në fjalë.

2. Nëse një person, i cili ka marrë ose vazhdon të marrë përfitime për sëmundje profesionale që mbulohen nga institucioni i njërit prej Shteteve Kontraktues, për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tij shëndetësore të shkaktuar nga kryerja e veprimtarisë që ka shkaktuar fillimisht sëmundjen në fjalë, i depoziton një kërkesë për përfitim Shtetit tjetër Kontraktues:

- institucioni i Shtetit të parë Kontraktues do të vazhdojë të mbulojë kostot e përfitimit, pavarësisht nga përkeqësimi i gjendjes shëndetësore, në përputhje me legjislacionin e tij përkatës;

- institucioni i Shtetit të dytë Kontraktues do të miratojë përfitimin në para në vlerën e diferencës midis shumës së përfitimit të llogaritur pas përkeqësimit të gjendjes shëndetësore dhe shumës së përfitimit që do t'i ishte dashur të paguante, në bazë të shfaqjes së sëmundjes, sipas legjislacionin e tij.

#### Seksioni 4

##### **Përfitimet e papunësisë**

#### Neni 24

##### **Bashkimi i periudhave të sigurimit**

1. Periudha e sigurimit e plotësuar sipas legjislacionit të njërit prej Shteteve Kontraktuese merret parasysh kur ushtrohet e drejta për një përfitim në para në rast të papunësisë sipas legjislacionit të Shtetit tjetër Kontraktues, me kusht që periudhat e sigurimit të mos mbivendosen dhe që personi të kishte qenë i siguruar për papunësinë përpara depozitimit të një kërkesë për një periudhë të tillë, siç përcaktohet në legjislacionin e Shtetit tjetër Kontraktues.

2. Përfitimi në para në rast të papunësisë miratohet nga institucioni kompetent sipas legjislacionit që ky institucion zbaton.





PJESA IV  
DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 25  
**Organet ndërlidhëse**

Organet ndërlidhëse do të përcaktohen përmes një marrëveshjeje administrative me qëllim zbatimin më efektiv të kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht për lidhjen e thjeshtë dhe të shpejtë të institucioneve të Shteteve Kontraktuese.

Neni 26  
**Detyrimet e organeve, institucioneve dhe ndihma administrative**

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përcaktojnë mënyrën e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje përmes një marrëveshjeje administrative, e cila hyn në fuqi njëkohësisht me këtë Marrëveshje.

2. Autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse dhe institucionet e Shteteve Kontraktuese do të komunikojnë me njëri-tjetrin për:

a) të gjitha masat e marra për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

b) çdo ndryshim në legjislacionin e tyre kombëtar në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. Organet dhe Institucionet e Shteteve Kontraktuese do t'i ofrojnë njëri-tjetrit ndihmë juridike dhe administrative pa pagesë.

4. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, organet dhe institucionet e të dyja Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe me të gjitha palët e interesuara ose përfaqësuesit e tyre.

5. Asnjë kërkesë apo dokument nuk do të refuzohet me arsyetimin se është shkruar në një gjuhë dhe shkrim zyrtar të Shtetit tjetër Kontraktues.

6. Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, gjuha dhe shkrimi në gjuhën malazeze dhe gjuha dhe shkrimi në gjuhën shqipe do të përdoren në mënyrë të barabartë.

7. Ekzaminimi mjekësor i kryer ekskluzivisht për zbatimin e legjislacionit të njërit prej Shteteve Kontraktuese dhe duke iu referuar personave me rezidencë ose vendqëndrim në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues, do të kryhet me kërkesë dhe me shpenzimet e institucionit kompetent në vendin e tij/saj të rezidencës apo vendqëndrimit të

përkohshëm. Ekzaminimet mjekësore në lidhje me zbatimin e legjislacionit të të dyja Shteteve Kontraktuese do të kryhen me shpenzimet dhe nga institucioni i rezidencës ose vendqëndrimit të përkohshëm të atij personi.

8. Institucioni kompetent i njërit prej Shteteve Kontraktuese do t'i sigurojë, me kërkesë dhe pa kosto, institucionit kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues çdo informacion dhe dokumentacion mjekësor që disponon në lidhje me paafësinë e një pale kërkuese ose përfituese.

Neni 27  
**Përrjashtimi nga tarifat dhe vërtetimet**

1. Përrjashtimi nga, ose reduktimi i detyrimeve dhe tarifave të skedarëve dhe dokumenteve me shkrim të bashkangjitura për qëllimin e zbatimit të legjislacionit të njërit prej Shteteve Kontraktuese do të zbatohet edhe për çdo skedar ose dokument tjetër me shkrim që depozitohet për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ose legjislacionit të Shtetit tjetër Kontraktues.

2. Çdo dokument identiteti, akt dhe skedar me shkrim i prodhuar dhe dorëzuar për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të përrjashtohet nga vërtetimi nga autoritetet diplomatike ose konsullore.

Neni 28  
**Depozitimi i kërkesave me shkrim**

1. Çdo kërkesë, deklaratë ose veprim që depozitohet në zbatim të kësaj Marrëveshjeje ose sipas legjislacionit të secilit prej Shteteve Kontraktuese te një Autoritet Kompetent, ose një institucion tjetër Kompetent i një Shteti Kontraktues, do të konsiderohet se i është dorëzuar Autoritetit Kompetent ose institucionit tjetër kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues.

2. Një kërkesë për përfitime e depozituar sipas legjislacionit të secilit prej Shteteve Kontraktuese në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohet si një kërkesë për përfitime e depozituar sipas legjislacionit të Shtetit tjetër Kontraktues.

3. Çdo aplikim, deklaratë ose veprim që duhet të dorëzohet brenda një afati të caktuar sipas legjislacionit të një Shteti Kontraktues te një autoritet, institucion ose institucion tjetër kompetent të atij Shteti Kontraktues do të konsiderohet se është dorëzuar në kohën e duhur nëse janë brenda të



njëtit afat, ato i dorëzohen autoritetit përkatës ose institucionit tjetër kompetent përkatës të Shtetit tjetër Kontraktues.

4. Në rastet e përmendura në paragrafët 1 deri në 3 të këtij neni, institucionet e sipërpërmendura, drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve ndërlidhëse, do t'i përcjellin pa vonesë këto aplikime, deklarata ose veprime tek institucionet përkatëse të Shtetit tjetër Kontraktues.

5. Dokumentet publike, certifikatat dhe/ose dokumentet e lëshuara nga organi ose institucioni i një Shteti Kontraktues për hir të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohen gjithashtu të vlefshme për një organ ose institucion të një Shteti tjetër Kontraktues.

#### Neni 29

##### **Pagesa e përfitimeve**

1. Institucioni përgjegjës për pagesën e përfitimeve sipas legjislacionit të një Shteti Kontraktues do të njohë përfitimet në monedhën zyrtare në atë Shtet Kontraktues.

2. Pagesa e përfitimeve e përmendur në nenin 1 të këtij neni për përfituesit me rezidencë në Shtetin tjetër Kontraktues do të bëhet në monedhë të konvertueshme (EUR).

3. Pagesat ndërmjet institucioneve të Shteteve Kontraktuese do të bëhen në monedhë të konvertueshme (EUR).

4. Konvertimi i përfitimeve në monedhën e Shtetit tjetër Kontraktues do të bëhet në përputhje me kursin e këmbimit që aplikohet në datën e transferimit.

#### Neni 30

##### **Kërkesa për përfitimet në para të paguara tepër**

1. Institucioni i njërit prej Shteteve Kontraktuese i cili ka paguar shumën e përfitimit më të lartë se shuma që duhet të marrë përfituesi, mund të kërkojë nga institucioni i Shtetit tjetër Kontraktues që shuma e paguar tepër të balancohet për të njëjtin lloj përfitimi, kundrejt shumave që duhet t'i paguhen përfituesit.

2. Shuma e paguar tepër do t'i dërgohet drejtpërdrejtë institucionit, i cili ka depozituar kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni.

#### Neni 31

##### **Procedura përmbartimore**

1. Dokumentet e detyrueshme të lëshuara nga një autoritet kompetent ose institucion në fushën e sigurimeve shoqërore, si dhe vendimet gjyqësore përmbartimore të secilit prej Shteteve Kontraktuese do të njihen edhe në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues.

2. Njohja mund të refuzohet vetëm nëse është në kundërshtim me rendin publik të Shtetit Kontraktues ku kërkohet njohja e vendimit ose dokumenteve.

3. Procedura e ekzekutimit të vendimeve dhe akteve të parevokueshme duhet të jetë në përputhje me legjislacionin që rregullon ekzekutimin e këtyre vendimeve dhe akteve të Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit kryhet ekzekutimi. Vendimi ose akti duhet të shoqërohet me një vërtetim që konfirmon se ky vendim ose akt mund të ekzekutohet (klauzola përmbartimore).

#### Neni 32

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Autoritetet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin bashkërisht çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje përmes negociatave

#### PJESA V

##### **DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### Neni 33

##### **Dispozita kalimtare**

1. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, nuk mund të ushtrohet asnjë e drejtë për përfitime për periudhën para hyrjes së saj në fuqi.

2. Çdo periudhë sigurimi e plotësuar sipas legjislacionit të Shteteve Kontraktuese përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të merret gjithashtu parasysh për qëllimin e përcaktimit të të drejtave për përfitimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

3. Kjo Marrëveshje do të zbatohet edhe për rastet e sigurimit që kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 34  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje do të jetë objekt ratifikimi.
2. Shtetet Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përmbushjen e të gjitha procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
3. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas muajit kur është pranuar njoftimi i fundit me shkrim, i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 35  
**Kohëzgjatja dhe zgjidhja e Marrëveshjes**

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Secili Shtet Kontraktues mund ta zgjidhë atë në çdo kohë me njoftim me shkrim drejtuar Shtetit tjetër Kontraktues të paktën gjashtë muaj përpara fundit të vitit kalendarik, përmes kanaleve diplomatike. Zgjidhja e Marrëveshjes hyn në fuqi duke filluar nga dita e parë e vitit të ardhshëm kalendarik.
2. Në rast të zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e saj do të vazhdojnë të mbeten në fuqi për të drejtat e fituara si dhe për kërkesat për ushtrimin e së drejtës të paraqitura përpara zgjidhjes së Marrëveshjes.

Neni 36  
**Efektet e zbatimit të Marrëveshjes mbi të drejtat e fituara ose të drejtat që do të fitohen në të ardhmen**

1. Në rast të zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të drejtat e fituara sipas Marrëveshjes do të mbeten në fuqi.
  2. Të gjitha të drejtat për përfitimet që do të realizoheshin deri në momentin e zgjidhjes së Marrëveshjes, do të mbeten në fuqi dhe kërkesat e paraqitura përpara zgjidhjes të Marrëveshjes do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.
- Nënshkruar në Podgoricë, më 27.2.2023, në dy origjinale në gjuhën malazeze, shqipe dhe angleze, ku të gjitha tekstet do të jenë njëloj autentike. Në rast të dallimeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË  
PËR MALIN E ZI**

**DEKRET**  
**Nr. 273, datë 4.10.2023**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 70/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi për sigurimet shoqërore”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

**LIGJ**  
**Nr. 71/2023**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E  
PJESSHME TË ZGJERUAR (EPA) PËR  
THEMELIMIN E REGJISTRIT TË  
DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA  
AGRESIONI I FEDERATËS RUSE  
KUNDËR UKRAINËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar (EPA) për themelimin e regjistrit të dëmeve të shkaktuara nga agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.9.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 274 datë 4.10.2023,  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bajram Begaj.**



ZËVENDËSMINISTRAT Rezolutë CM/Res(2023)3 16 maj 2023

**Rezoluta CM/Res(2023)3  
për Themelimin e Marrëveshjes së Pjeshme  
të Zgjeruar për Regjistrin e Dëmeve të  
shkaktuara nga Agresioni i Federatës Ruse  
kundër Ukrainës**

*(Miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 12 maj 2023,  
në mbledhjen e 1466-të të zëvendësministrave)*

Përfaqësuesit në Komitetin e Ministrave të Shqipërisë, Austrisë, Belgjikës, Kroacisë, Qipros, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Francës, Gjeorgjisë, Gjermanisë, Greqisë, Islandës, Irlandës, Italisë, Letonisë, Lihtenshtajnit, Lituanisë, Luksemburgut, Maltës, Republikës së Moldavisë, Monakos, Malit të Zi, Holandës, Maqedonisë së Veriut, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, San Marinos, Republikës Sllovaqe, Sllovenisë, Spanjës, Suedisë, Ukrainës dhe Mbretërisë së Bashkuar, si dhe përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, Kanadasë, Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

Duke pasur parasysh Statutin e Këshillit të Evropës (ETS nr. 1), i cili në preambulën e tij thekson kërkimin e paqes të bazuar në drejtësi;

Duke kujtuar detyrimet e të gjitha shteteve sipas nenit 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, përfshirë detyrimin për t'u përmbajtur në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare nga kërcënimet ose përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të çdo shteti, ose në çdo mënyrë tjetër, në kundërshtim me qëllimet e Kombeve të Bashkuara dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre ndërkombëtare me mjete paqësore;

Duke ritheksuar dënimin e tyre në termat më të ashpër të agresionit të Federatës Ruse kundër Ukrainës dhe duke shprehur mbështetjen e tyre të plotë për Ukrainën dhe solidaritetin e tyre me popullin e saj;

Duke i bërë thirrje Federatës Ruse të ndalojë menjëherë agresionin, të tërheqë plotësisht dhe pa kushte forcat e saj nga territori i njohur ndërkombëtarisht i Ukrainës dhe të lirojë të gjithë civilët e transferuar me forcë ose të dëbuar në mënyrë të paligjshme në territorin e Federatës Ruse ose në zonat e kontrolluara ose të pushtuara përkohësisht nga Federata Ruse, veçanërisht fëmijët;

Duke ritheksuar gjithashtu angazhimin e tyre të palëkundur për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht;

Duke kujtuar se më 16 mars 2022, Komiteti i Ministrave vendosi të përjashtojë Federatën Ruse nga Këshilli i Evropës si rezultat i agresionit të saj kundër Ukrainës, një agresion i tillë përbën shkelje të rëndë nga Federata Ruse të detyrimeve të saj sipas nenit 3 të Statutit të Këshillit të Evropës dhe sipas së drejtës ndërkombëtare;

Duke dënuar të gjitha shkeljet e së drejtës ndërkombëtare, përfshirë të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare, në veçanti sulmet kundër civilëve dhe objekteve civile, përfshirë infrastrukturën civile, trashëgiminë kulturore dhe fetare dhe mjedisin e Ukrainës dhe të bindur për domosdoshmërinë urgjente për të siguruar llogaridhënie gjithëpërfshirëse në kontekstin e agresionit të Federatës Ruse kundër Ukrainës;

Duke kujtuar në këtë aspekt nenet e vitit 2001 mbi përgjegjësinë e shteteve për aktet ndërkombëtarisht të gabuara, parimet dhe udhëzimet themelore të OKB-së të vitit 2005 mbi të drejtën për një mjet juridik dhe dëmshpërblim për viktimat e shkeljeve të rënda të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, si dhe udhëzimet e Komitetit të Ministrave të vitit 2011 për çrrënjosjen e pandëshkueshmërisë për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut;

Faqja e internetit: [www.coe.int/cm](http://www.coe.int/cm)

Duke kujtuar vendimet e Komitetit të Ministrave, të 15 shtatorit 2022 dhe 24 shkurtit 2023, duke përsëritur përpjekjet e vazhdueshme, në bashkëpunim me Ukrainën, për të siguruar dëmshpërblim të plotë për dëmin, humbjen ose lëndimin e shkaktuar nga shkeljet e së drejtës ndërkombëtare nga Federata Ruse në Ukrainë ;

Duke pasur parasysh rezolutën A/RES/ES-11/5, të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 14 nëntor 2022, "Përparimi i kompensimit dhe dëmshpërblimit për agresionin kundër Ukrainës", duke pranuar, ndër të tjera, se Federata Ruse duhet të mbajë pasojat ligjore të të gjitha akteve të saj të paligjshme ndërkombëtarisht në ose kundër Ukrainës, përfshirë kompensimin për lëndimin dhe për çdo dëm të shkaktuar nga akte të tilla, dhe duke vërejtur se kjo rezolutë njih gjithashtu



nevojën për krijimin e një mekanizmi ndërkombëtar për dëmshpërblimin dhe rekomandon krijimin e një regjistri ndërkombëtar të dëmeve, në bashkëpunim me Ukrainën;

Duke vërejtur se Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, në rezolutën e saj 2482 (2023) mbi “Aspektet ligjore dhe të drejtave të njeriut të agresionit të Federatës Ruse kundër Ukrainës”, ritheksoi thirrjen e saj ndaj shteteve anëtare për të ngritur një mekanizëm ndërkombëtar kompensimi dhe, si hapi i parë, një regjistër ndërkombëtar të dëmeve;

Të bindur se krijimi i një regjistri të dëmeve përbën një hap të parë domethënës për të siguruar kompensimin në kohë për viktimat e akteve të paligjshme ndërkombëtare të Federatës Ruse në ose kundër Ukrainës;

Duke pasur parasysh rezolutën statutore Res(93)28 të Komitetit të Ministrave për marrëveshjet e pjesshme dhe të zgjeruara;

Duke pasur parasysh rezolutën Res(96)36 të Komitetit të Ministrave që përcakton kriteret për marrëveshjet e pjesshme dhe të zgjeruara të Këshillit të Evropës, të ndryshuar nga rezoluta CM/Res(2010)2;

Duke pasur parasysh vendimin e datës 19 prill 2023, ku Komiteti i Ministrave autorizoi krijimin e një Regjistri të Dëmeve të shkaktuara nga agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës në formën e një Marrëveshjeje të Pjesshme të Zgjeruar në kuadër të Këshillit të Evropës,

Vendosin të krijojnë Marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar mbi Regjistrin e Dëmeve të Shkaktuara nga Agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës (në vijim “Regjistri”), i rregulluar nga Statuti bashkëlidhur, i cili do të shërbejë si një procesverbal në formë dokumentare të provave dhe kërkon informacion mbi dëmin, humbjen ose lëndimin e shkaktuar të të gjithë personave fizikë dhe juridikë të interesuar, si dhe shtetit të Ukrainës (përfshirë autoritetet rajonale dhe lokale, subjektet shtetërore ose të kontrolluara), të shkaktuara në ose pas datës 24 shkurt 2022 në territorin e Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht, duke u shtrirë në ujërat e saj territoriale, nga aktet e paligjshme ndërkombëtare të Federatës Ruse në ose kundër Ukrainës;

Bien dakord që Regjistri të krijohet për një periudhë fillestare prej tre vjetësh;

Bien dakord për të rishikuar funksionimin e Regjistrit, me synimin për të shqyrtuar vazhdimësinë e funksionimit të tij, deri në fund të periudhës fillestare prej tre vjetësh;

Ftojnë të gjitha shtetet anëtare dhe vëzhguese të Këshillit të Evropës, si dhe shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, të bëhen anëtarë të Marrëveshjes së pjesshme të zgjeruar, në përputhje me Statutin e Regjistrit;

U bëjnë thirrje shteteve anëtare dhe vëzhguese të Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare që të bashkëpunojnë me Regjistrin për të lehtësuar punën e tij;

Bien dakord të shpërndajnë informacionin mbi Regjistrin sa më gjerë që të jetë e mundur për pretenduesit e mundshëm dhe publikun në përgjithësi, të shtetet dhe organizatat dhe organet përkatëse ndërkombëtare;

Bien dakord që të vazhdojnë të punojnë, në bashkëpunim me Ukrainën dhe organizatat dhe organet përkatëse ndërkombëtare, drejt krijimit nga një instrument ndërkombëtar i veçantë të një mekanizmi të ardhshëm ndërkombëtar kompensimi, i cili të mund të përfshijë një komision për dëmet dhe fond kompensimi, ku puna e Regjistrit, duke përfshirë platformën e tij digjitale me të gjitha të dhënat në lidhje me pretendimet dhe provat e regjistruara në të, synohet të përbëjë pjesë integrale.

## SHTOJCË E REZOLUTËS CM/RES(2023)3 STATUTI I REGJISTRIT TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA AGRESIONI I FEDERATËS RUSE KUNDËR UKRAINËS

Neni 1

### Mandati i Regjistrit të Dëmeve

1.1 Regjistri i Dëmeve të shkaktuara nga agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës (në vijim “Regjistri”) do të shërbejë si një procesverbal, në formë dokumentare, i provave dhe informacionit të pretendimeve për dëmin, humbjen ose lëndimin e shkaktuar, më ose pas datës 24 shkurt 2022, në territorin e Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht, duke u shtrirë në ujërat e saj territoriale, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të interesuar, si dhe shtetin e Ukrainës, përfshirë autoritetet e saj rajonale dhe lokale, në pronësi të



shtetit ose subjektet e kontrolluara, nga aktet e paligjshme ndërkombëtare të Federatës Ruse në ose kundër Ukrainës.

1.2 Regjistri do të krijohet si një platformë për bashkëpunimin ndërqeveritar, duke vepruar brenda kuadrit institucional të Këshillit të Evropës.

## Neni 2

### Funksionet e Regjistrit të Dëmeve

2.1 Regjistri merr dhe përpunon informacionin për pretendimet për dëme dhe provat; kategorizon, klasifikon dhe organizon kërkesa të tilla, vlerëson dhe përcakton pranueshmërinë e kërkesave për t'u përfshirë në regjistër dhe regjistron kërkesat e pranueshme për qëllime të shqyrtimit dhe gjykimit të tyre në të ardhmen. Regjistri nuk do të ketë asnjë funksion gjykimi në lidhje me këto pretendime, duke përfshirë përcaktimin e përgjegjësisë dhe ndarjen e ndonjë pagese ose kompensimi.

2.2 Kriteret e pranueshmërisë për regjistrimin e kërkesave në Regjistër për qëllime të shqyrtimit dhe gjykimit të tyre në të ardhmen, do të përcaktohen në rregullat dhe rregulloret e Regjistrit, duke pasur parasysh se këto pretendime do të bëhen në lidhje me dëmin, humbjen ose lëndimin që është shkaktuar:

a) më ose pas datës 24 shkurt 2022;

b) në territorin e Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht, duke u shtrirë në ujërat e saj territoriale;

c) nga aktet e paligjshme ndërkombëtare të Federatës Ruse në ose kundër Ukrainës.

2.3 Kërkesat, provat dhe informacionet përkatëse do t'i dorëzohen Regjistrit nga personat fizikë dhe juridikë të interesuar, si dhe nga shteti i Ukrainës (duke përfshirë autoritetet e saj rajonale dhe lokale, dhe subjektet shtetërore ose të kontrolluara).

2.4 Regjistri do të bashkëpunojë me partnerët përkatës kombëtarë dhe ndërkombëtarë për qëllime të promovimit dhe bashkërendimit të mbledhjes së provave të dëmit, humbjes ose lëndimit të shkaktuar nga aktet e paligjshme ndërkombëtare të Federatës Ruse në ose kundër Ukrainës.

2.5 Puna e Regjistrit, duke përfshirë platformën e tij digjitale me të gjitha të dhënat në lidhje me pretendimet dhe provat e regjistruara në të, synon të përbëjë komponentin e parë të një mekanizmi të ardhshëm ndërkombëtar kompensimi që do të

krijohet nga një instrument ndërkombëtar i veçantë në bashkëpunim me Ukrainën (në vijim “një Mekanizëm Kompensimi”). Forma e saktë e një Mekanizmi Kompensimi në të ardhmen duhet të përcaktohet, por mund të përfshijë një komision për dëme dhe fond kompensimi të mandatuar për të shqyrtuar dhe gjykuar pretendimet dhe/ose të paguajë kompensim për dëmin, humbjen ose lëndimin e shkaktuar nga aktet e paligjshme ndërkombëtare të Federatës Ruse në ose kundër Ukrainës. Regjistri, nëpërmjet drejtorit të tij ekzekutiv dhe me mbështetjen e Sekretariatit të tij, do të marrë pjesë dhe do të lehtësojë, sipas rastit, punën që synon krijimin e një mekanizmi të tillë kompensimi dhe do të marrë hapat e nevojshëm për përgatitjen që Regjistri të transferohet në një mekanizëm kompensimi në përputhje me këtë Statut.

## Neni 3

### Statusi juridik dhe selia

3.1 Regjistri do të ketë personalitet juridik sipas ligjit kombëtar të Mbretërisë së Holandës dhe Ukrainës dhe në këtë mënyrë gëzon zotësi juridike që është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij, përmbushjen e mandatit dhe mbrojtjen e interesave të tij, në veçanti kapacitetin që të kontraktojë dhe të blejë e disponojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

3.2 Regjistri do të ketë kapacitet për të hyrë në marrëveshje me shtetet, organizatat ndërkombëtare dhe organet në vazhdim të mandatit të tij.

3.3 Regjistri do të ketë selinë e tij në Hagë, Mbretëria e Holandës. Statusi dhe funksionimi i Regjistrit në Mbretërinë e Holandës do të rregullohet nga një Marrëveshje e Shtetit Pritës të lidhur nga Këshilli i Evropës.

3.4 Regjistri do të ketë gjithashtu një zyrë satelitore në Ukrainë, me qëllim lidhjen me Qeverinë e Ukrainës dhe lehtësimin e shtrirjes dhe kontaktit me pretenduesit e mundshëm dhe publikun në përgjithësi në Ukrainë, veçanërisht për ekzistencën dhe qëllimin e Regjistrit dhe procedurën e depozitimit të një kërkesë për dëmin.

3.5 Marrëveshja e Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës do të zbatohet për Regjistrin dhe zyrtarët e tij, duke përfshirë zyrën satelitore të Regjistrit në Ukrainë.



#### Neni 4 Pjesëmarrja

4.1 Çdo shtet anëtar ose vëzhgues i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, si dhe çdo shtet tjetër që ka votuar në favor të rezolutës A/RES/ES-11/5 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të datës 14 nëntor 2022 “Përparimi i kompensimit dhe dëmshpërblimit për agresionin kundër Ukrainës”, mund t’i bashkohet Regjistrin si Pjesëmarrës me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

4.2 Çdo shtet anëtar ose vëzhgues i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, si dhe çdo shtet tjetër që ka votuar në favor të rezolutës A/RES/ES-11/5 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 14 nëntor 2022, “Përparimi i kompensimit dhe dëmshpërblimit për agresionin kundër Ukrainës” mund t’i bashkohet Regjistrin si anëtar i asociuar me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Anëtarët e asociuar inkurajohen të japin kontribute vullnetare për Regjistrin në përputhje me nenin 10. Anëtarët e asociuar, në çdo kohë, mund të bëhen pjesëmarrës me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

4.3 Konferenca e Pjesëmarrësve mund të autorizojë çdo shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare që ka kërkuar një gjë të tillë për t’u bashkuar me Regjistrin si pjesëmarrës ose anëtar i asociuar, duke marrë parasysh veçanërisht pozicionin/qëndrimin e qeverisë së Ukrainës.

#### Neni 5 Konferenca e Pjesëmarrësve

5.1 Konferenca e pjesëmarrësve (në vijim “Konferenca”) do të përbëhet nga një përfaqësues i caktuar nga secili pjesëmarrës. Emërime të tilla do t’i komunikohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

5.2 Konferenca do të zgjedhë nga anëtarët e saj një kryetar dhe dy zëvendëskryesues për një periudhë trevjeçare.

5.3 Konferenca:

a) do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për përmbushjen e mandatit të Regjistrin;

b) do t’iu rekomandojë pjesëmarrësve dhe anëtarëve të asociuar masa për të avancuar qëllimet e Regjistrin;

c) do të miratojë rregullat dhe rregulloret e propozuara nga Bordi për udhëheqjen e punës së Regjistrin;

d) do të emërojë anëtarët e Bordit;

e) do të caktojë drejtorin ekzekutiv me propozim të qeverisë së Ukrainës;

f) do të miratojë buxhetin vjetor të Regjistrin;

g) do të miratojë raportin vjetor të veprimtarisë së Regjistrin;

h) do të kryejë çdo funksion tjetër që i është dhënë nga ky Statut.

5.4 Konferenca do të mbledhet aq herë sa është e nevojshme, por të paktën një herë në vit. Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit në lidhje me Konferencën do të përballohen nga çdo pjesëmarrës dhe anëtar i asociuar. Konferenca mund të ushtrojë vendimmarrjen e saj me procedurë të shkruar dhe me mjete elektronike.

5.5 Konferenca do të miratojë vendimet e saj me një shumicë prej dy të tretave të votave të hedhura, ku secili pjesëmarrës ka një votë. Çështjet procedurale do të zgjidhen me shumicën e votave të hedhura. Konferenca do të miratojë rregullat e veta të procedurës dhe çdo marrëveshje tjetër të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të saj.

5.6 Pa cenuar nenin 5, paragrafi 7, anëtarët e asociuar mund të marrin pjesë në mbledhjet e Konferencës pa të drejtë vote. Anëtarët e asociuar mund të bëjnë deklaratë me gojë ose me shkrim në mbledhjet e Konferencës.

5.7 Anëtarët e asociuar që kanë dhënë kontribute vullnetare në Regjistrin në një shumë të barabartë me shumën e përcaktuar nga Konferenca për Pjesëmarrësit në përputhje me nenin 10, do të kenë gamën e plotë të të drejtave të pjesëmarrësve gjatë vitit financiar për të cilin ata dhanë një kontribut të tillë.

5.8 Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës mund të marrë pjesë ose të përfaqësohet në mbledhjet e Konferencës pa të drejtë vote. Konferenca mund të ftojë përfaqësues të organeve përkatëse të Këshillit të Evropës ose organizatave ndërkombëtare që të marrin pjesë në mbledhjet e saj ose në një pjesë të mbledhjeve të saj, pa të drejtë vote, sipas pikave të rendit të ditës së saj. Ajo mund të ftojë edhe ekspertë që të jenë të pranishëm për pika të veçanta të rendit të ditës, pa të drejtë vote.



## Neni 6 Bordi

6.1 Bordi i Regjistrisë (në vijim “Bordi”) do të përbëhet nga shtatë anëtarë, duke marrë parasysh integritetin, përvojën dhe ekspertizën e tyre shumëdisiplinore të nevojshme për funksionimin efikas të Regjistrisë, veçanërisht në lidhje me të drejtën ndërkombëtare, dëmet dhe pretendimet e luftës, kontabilitetin, dhe vlerësimin e humbjeve, si dhe gjininë dhe ekuilibrin gjeografik global. Konferenca mund të ndryshojë numrin e anëtarëve të Bordit nëse është e nevojshme për të garantuar funksionimin efikas të Regjistrisë, duke marrë parasysh vëllimin dhe kompleksitetin e pretendimeve dhe ngarkesën e Bordit.

6.2 Një nga anëtarët e Bordit do të emërohet nga Konferenca nga radhët e kandidatëve të emëruar nga qeveria e Ukrainës. Anëtarët e tjerë të Bordit do të emërohen nga Konferenca nga radhët e kandidatëve të emëruar nga pjesëmarrësit dhe anëtarët e asociuar. Në bazë të nenit 6, paragrafi 3, të gjithë anëtarët e Bordit emërohen për një mandat trevjeçar, i rinovueshëm një herë.

6.3 Procedurat e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Bordit do të përcaktohen nga Konferenca.

6.4 Anëtarët e Bordit duhet të mblidhen në cilësinë e tyre individuale, të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe të jenë të disponueshëm për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive. Anëtarët e Bordit do të shpërblehen nga Regjistri për punën e tyre sipas kushteve të përcaktuara nga Konferenca.

6.5 Bordi, pa cenuar nenin 5:

a) do të ketë përgjegjësi për ushtrimin e funksioneve të Regjistrisë;

b) do të propozojë rregullat dhe rregulloret që rregullojnë punën e Regjistrisë dhe t'i zbatojë ato sipas rastit, duke përfshirë, veçanërisht në lidhje me përcaktimin e kategorive të kërkesave, procedurat për marrjen, përpunimin dhe regjistrimin e kërkesave, formatin e formularëve të kërkesave dhe kërkesat për prova në lidhje me çdo kategori pretendimesh që do të miratohen nga Konferenca;

c) do të ketë autoritetin përfundimtar në përcaktimin e pranueshmërisë së kërkesave për t'u regjistruar në regjistër, bazuar në rekomandimin e drejtorit ekzekutiv;

d) do të kryejë çdo funksion tjetër të nevojshëm për përmbushjen e mandatit të Regjistrisë që nuk i është dhënë nga ky Statut, Konferencës, drejtorit ekzekutiv ose Sekretariatit.

6.6 Bordi do të caktojë datën kur Regjistri do të jetë i hapur për paraqitjen e kërkesave, provave dhe informacioneve përkatëse.

6.7 Bordi do të miratojë rregullat e veta të procedurës dhe çdo marrëveshje tjetër të nevojshme për zbatimin e aktivitetëve të tij. Bordi do të emërojë një kryesues dhe një zëvendëskryesues midis anëtarëve të tij për një mandat trevjeçar, i cili mund të rinovohet një herë.

6.8. Bordi do të mblidhet rregullisht, por të paktën mbi baza tremujore, për të përcaktuar se cilat pretendime duhet të regjistrohen në regjistër dhe për të marrë çdo vendim tjetër të nevojshëm për të kryer funksionet e tij. Drejtori ekzekutiv do të marrë pjesë në këto takime në cilësinë e këshillimit.

6.9 Bordi do t'i japë Konferencës raporte tremujore. Raporte të tilla do të përfshijnë numrin e kërkesave të pranuar dhe numrin e kërkesave të pranueshme të regjistruara në regjistër, kategoritë përkatëse dhe shumën totale të kompensimit të kërkuar (nëse është e zbatueshme). Raporte të tilla do të përfshijnë gjithashtu përmbledhjen e çështjeve të tjera të rëndësishme faktike ose ligjore të rëndësishme për punën e Regjistrisë.

## Neni 7 Drejtori ekzekutiv

7.1 Drejtori ekzekutiv përfaqëson Regjistrinë dhe ka të drejtë të veprojë në emër të tij.

7.2 Drejtori ekzekutiv ka të drejtë të lidhë kontrata dhe marrëveshje në emër të Regjistrisë. Marrëveshjet e lidhura nga drejtori ekzekutiv në emër të Regjistrisë me organet kombëtare ose ndërkombëtare që parashikojnë bashkërendimin e mbledhjes së provave ose çdo shkëmbim informacioni mbi pretendimet ose provat, miratohen nga Bordi.

7.3 Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i delegon drejtorit ekzekutiv kompetencat e nevojshme për ushtrimin e detyrave të drejtorit ekzekutiv në lidhje me Sekretariatin.

7.4 Drejtori ekzekutiv:

a) do të ketë përgjegjësi të përditshme për mbikëqyrjen dhe administrimin e punës së Sekretariatit të Regjistrisë;





b) së bashku me Sekretariatën, të sigurojë mbështetje thelbësore, teknike, administrative dhe organizative për punën e Konferencës dhe Bordit, duke përfshirë ndërlidhjen e rregullt dhe përgatitjen e takimeve të tyre;

c) do të jetë përgjegjës për përcjelljen e kërkesave të Bordit për miratim për regjistrim në regjistrë;

d) do të ndërlidhet me organet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare për çështje të ndryshme që lidhen me punën e Regjistrit dhe procesin e mbledhjes së kërkesave dhe provave;

e) do të ndërlidhet me qeverinë e Mbretërisë së Holandës dhe qeverinë e Ukrainës për çështje të ndryshme administrative që lidhen me punën e Regjistrit;

f) do të kryejë çdo funksion tjetër që i është caktuar drejtorit ekzekutiv me këtë Statut.

7.5 Drejtori ekzekutiv do të përcaktohet nga Konferenca me propozim të Qeverisë së Ukrainës dhe do të emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, duke marrë parasysh integritetin, përvojën dhe ekspertizën shumëdisiplinore të nevojshme për këtë post. Drejtori ekzekutiv mund të shkarkohet për arsye të justifikuar nga Sekretari i Përgjithshëm pas një procedure të iniciuar nga qeveria e Ukrainës ose Sekretari i Përgjithshëm dhe pas marrëveshjes nga Konferenca.

#### Neni 8

### **Sekretariati i Regjistrit**

8.1 Sekretariati, nën autoritetin e drejtorit ekzekutiv, do të sigurojë mbështetje thelbësore, teknike dhe administrative për mirëmbajtjen dhe funksionimin e Regjistrit.

8.2 Pa cenuar nenin 8, paragrafin 3, Sekretariati do të ketë autonomi të plotë administrative nga Këshilli i Evropës dhe organet e tij.

8.3 Rregullorja e stafit të Këshillit të Evropës do të zbatohet për Sekretariatën.

#### Neni 9

### **Pavarësia**

9.1 Në kryerjen e detyrave të tyre, anëtarët e Bordit, drejtori ekzekutiv dhe Sekretariati nuk do të kërkojnë ose marrin udhëzime nga asnjë qeveri, organizatë ndërkombëtare ose nga ndonjë autoritet tjetër jashtë regjistrit.

9.2 Çdo pjesëmarrës dhe anëtar i asociuar i Regjistrit, si dhe Këshilli i Evropës dhe organet e tij, angazhohen që të respektojnë karakterin ekskluzivisht të pavarur të përgjegjësive të anëtarëve të Bordit, drejtorit ekzekutiv dhe Sekretariatit dhe të mos kërkojnë të ndikojnë te ta në përmbushjen e përgjegjësive të tyre.

#### Neni 10

### **Financimi dhe buxheti**

10.1 Regjistri do të ketë buxhetin e tij në përputhje me rezolutën statutores Res(93)28. Konferenca do të miratojë çdo vit buxhetin e Regjistrit për shpenzimet, të përgatitur nga drejtori ekzekutiv.

10.2 Regjistri do të financohet nëpërmjet kontributeve vjetore të pjesëmarrësve të tij dhe kontributeve vullnetare të anëtarëve të tij të asociuar.

10.3 Konferenca do të përcaktojë si shumën e kontributeve vjetore të pjesëmarrësve të saj, ashtu edhe kontributet vullnetare të rekomanduara të anëtarëve të saj të asociuar. Këto kontribute duhet të bazohen, si rregull, në kriteret për përcaktimin e shkallës vjetore të kontributeve në buxhetin e përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe mund të rregullohen në përputhje me parimet mbi të cilat bazohet ajo shkallë.

10.4 Regjistri mund të marrë dhe të përdorë grante shtesë vullnetare dhe kontribute të tjera që lidhen me punën e tij, duke përfshirë kontributet në natyrë, me kusht që të autorizohet paraprakisht nga Konferenca. Këto kontribute do të jenë në përputhje me qëllimet dhe funksionet e Regjistrit.

10.5 Konferenca do të miratojë çdo vit llogaritë vjetore të Regjistrit, të cilat do të hartohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës në përputhje me rregulloret financiare të Këshillit të Evropës dhe do t'i dorëzohen Konferencës të shoqëruara me raportin e Audituesit të Jashtëm, siç parashikohet në Rregulloren Financiare. Për të shkarkuar Sekretarin e Përgjithshëm nga përgjegjësia për menaxhimin e vitit financiar në fjalë, Konferenca do t'i transmetojë Komitetit të Ministrave llogaritë vjetore, së bashku me miratimin ose çdo koment të tij, dhe raportin e hartuar nga Audituesi i Jashtëm, siç parashikohet në Rregulloren Financiare.

10.6 Rregulloret financiare të Këshillit të Evropës do të zbatohen për miratimin dhe menaxhimin e



buxhetit të Regjistrit, duke marrë parasysh dispozitat e këtij Statuti.

#### Neni 11 **Konfidencialiteti**

11.1 Në bazë të nenit 11, paragrafi 2, çdo informacion mbi pretendimet dhe dëmet e marra nga Regjistri, duke përfshirë çdo provë, do të trajtohet si konfidencial.

11.2 Rregullat për aksesin në dokumente dhe mbrojtjen e të dhënave në lidhje me pretendimet e paraqitura në Regjistrë, propozohen nga Bordi dhe miratohen nga Konferenca, duke përfshirë ndarjen e informacionit sipas dispozitave të këtij Statuti, veçanërisht për qëllimet e nenit 2, paragrafi 4.

#### Neni 12 **Rregullat dhe rregulloret e Këshillit të Evropës**

Konferenca, me një propozim të justifikuar nga Bordi, mund të miratojë derogime nga rregullat dhe rregulloret e zbatueshme të Këshillit të Evropës, nëse kjo kërkohet për ushtrimin efikas të funksioneve të Regjistrit.

Këto derogime do t'i komunikohen Komitetit të Ministrave dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

#### Neni 13 **Ndryshimet**

Ky Statut mund të ndryshohet vetëm me vendim të Komitetit të Ministrave, në përbërjen e tij të kufizuar të përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrëse të Regjistrit, me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me një formulim identik të vendimit të Konferencës.

#### Neni 14 **Transferimi, vijimi dhe përfundimi**

14.1 Pas krijimit të një Mekanizmi Kompensimi siç përmendet në nenin 2, paragrafi 5, puna e Regjistrit do të transferohet sipas rastit në atë Mekanizëm Kompensimi, në mënyrë që të garantojë funksionimin e pandërprerë të Regjistrit deri në përfundimin e tij dhe që të vendosë informacion mbi pretendimet dhe provat e përfshira aty në dispozicion të këtij Mekanizmi Kompensimi. Një

transferim i tillë do të përfshijë platformën digjitale të Regjistrit, duke përfshirë të gjithë informacionin në lidhje me pretendimet dhe provat e përfshira në të, dokumentacionin tjetër, përfshirë arkivat, pasurinë e tij të luajtshme dhe të paluajtshme, duke përfshirë, por pa u kufizuar të llogaritë bankare, pajisjet e TI-së, softuerin dhe çdo licencë për këtë, kontratat dhe rregullimet e Regjistrit, si dhe çdo të dhënë shoqëruese.

14.2 Bordi do të propozojë rregullat dhe procedurat e nevojshme me synimin për të siguruar, sipas rastit, një transferim të butë të Regjistrit të ky Mekanizëm Kompensimi. Këto rregulla do të miratohen nga Konferenca.

14.3 Ky Mekanizëm Kompensimi synohet të jetë pasardhës i Regjistrit pas përfundimit të këtij transferimi.

14.4 Pas përfundimit të një transferimi të tillë, siç përcaktohet nga Bordi dhe konfirmohet nga Konferenca, Regjistri do të përfundojë si një Marrëveshje e pjesshme e zgjeruar e Këshillit të Evropës.

#### Neni 15 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Pjesëmarrësit do të kërkojnë të zgjidhin çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin ose interpretimin e dispozitave të këtij Statuti me negociata ose me çdo mjet tjetër të zgjidhjes paqësore të pranuar me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet tyre.

#### Neni 16 **Tërheqja dhe dëbimi**

16.1 Çdo pjesëmarrës ose anëtar i asociuar mund të tërhiqet nga Regjistri me anë të një njoftimi dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

16.2 Sekretari i Përgjithshëm do të pranojë marrjen e njoftimit dhe do të informojë pjesëmarrësit dhe anëtarët e asociuar të Regjistrit.

16.3 Tërheqja e një pjesëmarrësi do të hyjë në fuqi në fund të vitit financiar kur është njoftuar, nëse një njoftim i tillë është dhënë para datës 1 qershor të atij viti financiar, ose në fund të vitit financiar pasardhës, nëse është dhënë njoftimi për tërheqjen në ose pas datës 1 qershor të vitit financiar. Tërheqja



e një anëtari të asociuar do të hyjë në fuqi pas marrjes së njoftimit.

16.4 Në përputhje me dispozitat e zbatueshme të rregulloreve financiare të Këshillit të Evropës, Konferenca do të shqyrtojë pasojat financiare të tërheqjes ose përjashtimit të një pjesëmarrësi ose një anëtari të asociuar dhe do të bëjë rregullimet e duhura.

16.5 Sekretari i Përgjithshëm do të informojë menjëherë Pjesëmarrësin në fjalë për pasojat e tërheqjes së tij në përputhje me nenin 16, paragrafi 3.

16.6 Konferenca mund të vendosë që çdo pjesëmarrës ose anëtar i asociuar që vepron në një mënyrë që nuk është në përputhje me mandatin e Regjistrit ose që pengon funksionet e tij, të pushojë së qeni pjesëmarrës ose anëtar i asociuar i Regjistrit që nga data e përcaktuar nga Konferenca.

### DEKRET

Nr. 274, datë 4.10.2023

### PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

#### DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 71/2023, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesëshme të zgjeruar (EPA) për themelimin e regjistrit të dëmeve të shkaktuara nga agresioni i Federatës Ruse kundër Ukrainës”.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË

**Bajram Begaj**

### LIGJ

Nr. 75/2023

### PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 74/2014, “PËR ARMËT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

Në ligjin nr. 74/2014 “Për armët”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

#### Neni 1

Shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 14 ndryshohet si më poshtë:

“dh) licencë për tregtimin e armëve të kategorisë “B” dhe për import dhe tregtim të armëve të kategorive “C” (gjahut) dhe “D” (sportive), pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.”.

#### Neni 2

Në nenin 18/2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Licenca për tregtimin e armëve të kategorisë “B” dhe për import dhe tregtim të armëve të gjahut, sportive, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1.1 Për veprimtarinë e tregimit të armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet licencë nga komisioni përgjegjës në Policinë e Shtetit.”.

3. Në pikën 2 fjala “këtë” zëvendësohet me fjalën “këto”.

#### Neni 3

Në pikën 1 të nenit 19 pas fjalës “transportit” shtohet fjala “tregtimit”.



Neni 4  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.9.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 275, datë 4.10.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

**DEKRET**  
**Nr. 275, datë 4.10.2023**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 75/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 ‘Për armët’”, të ndryshuar.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 262, datë 3.10.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Antonela Bezhan Beleraj
2. Toto Mynyr Resulaj
3. Eralb Erion Sinani

4. Kadri Ismajl Gjonpapaj
5. Arzie Artur Zwanefeld (Turuku)
6. Vasilios Riza Muskaj

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 263, datë 3.10.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, nenit 14, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Julinda Hiqmet Ibrahimaj
2. Kristel Doriel Alushi
3. Kalvin Doriel Alushi
4. Vladimir Zef Hasani
5. Evelin Vladimir Hasani
6. Vjola Jasin Serjani
7. Kiselda Astrit Dervishaj
8. Nami Carlo Liguori
9. Marindo Kujtim Beka

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**



**DEKRET**  
**Nr. 264, datë 3.10.2023**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË**  
**SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

I lejohej lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit të mëposhtëm:

1. Elton Gezim Tufi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 265, datë 3.10.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË**  
**SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Durim Avni Çejku
2. Adem Qerim Kurpali
3. Drita Dinë Karakushi
4. Alemi Nexhat Badalli
5. Dhurata Shukri Gutaj

6. Rafet Taip Hoxhaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 266, datë 3.10.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË**  
**SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Hira Hatim Mehmeti
2. Bashkim Agim Kokollari
3. Flamur Hatim Mehmeti
4. Dren Ymeri Mariqi
5. Mirije Amet Mehmeti (Gutaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**



**DEKRET**  
**Nr. 267, datë 3.10.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË**  
**SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Landrit Astrit Tola
2. Festina Dugagjin Kabashi
3. Fatime Murat Hoxha (Kabashi)
4. Arben Ismen Vilaj
5. Shyt Shaban Karakushi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 268, datë 3.10.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË**  
**SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Besim Amdi Elezkurtaj
2. Kelmend Irfan Spahiu

3. Arben Hasan Mulaj
4. Skender Garib Arifaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 269, datë 3.10.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË**  
**SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Anna Saverio Monteleone
2. Dardane Avdyl Kusari (Prushi)
3. Laura Lush Krekaj Shala

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**

**DEKRET**  
**Nr. 270, datë 3.10.2023**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË**  
**SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,



## DEKRETOJ:

Neni 2

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Gjin Mentor Hadri
2. Muharrem Fadil Selimaj
3. Amor Naser Rudi
4. Shkumbin Jeton Spahiu
5. Vesel Besnik Hoxhaj
6. Zyber Kadrush Godeni
7. Blerim Sefedin Memaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET****Nr. 271, datë 3.10.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

## DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Visar Mustafa Gjana
2. Driton Sadri Lushaj
3. Vlora Ismet Bajrami (Lala)
4. Elba Ismail Kokaj
5. Rona Ismail Kokaj
6. Leonora Ismet Tola (Nezaj)

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET****Nr. 272, datë 3.10.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

## DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Elda Visar Malazogu
2. Bleona Rufat Sinanaj
3. Bedridin Nezir Rexha
4. Berat Asmon Tafa
5. Dhurata Ekrem Nixha (Tara)
6. Arta Skënder Dushi (Polloshka)
7. Donat Elgen Polloshka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**DEKRET****Nr. 277, datë 5.10.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, nenit 9, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:****Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të shtetasit të mëposhtëm:

1. Tim Eduart Civeja

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
Bajram Begaj**

**VENDIM****Nr. 569, datë 6.10.2023****PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2023, MIRATUAR  
PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE  
QEVERITARE, PËR PËRBALLIMIN E  
SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT NË  
TIRANË TË SAMITIT TË PROCESIT TË  
BERLINIT, DATË 16 TETOR 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi prej 51 000 000 (pesëdhjetë e një milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të organizimit në Tiranë të Samitit të Procesit të Berlinit, datë 16 tetor 2023.

2. Efekti financiar, prej 51 000 000 (pesëdhjetë e një milionë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

**URDHËR****Nr. 315, datë 13.9.2023****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; në VKM-në nr. 870, datë 14.12.2021, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të autoritetit kontraktor, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore të institucionit.

2. Për nënshkrimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, jashtë qendrës së punës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në largësi mbi 100 km si dhe jashtë vendit.

3. Nënshkrimin e kontratave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.





4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 14, datë 16.1.2023, "Për delegim kompetencash", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME  
Igli Hasani

#### URDHËR

Nr. 316, datë 13.9.2023

#### PËR DELEGIM KOMPETENCE

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm", nenet 22 e vijues, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", nenin 19, pika 2, e ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit",

#### URDHËROJ:

Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si vijon:

1. Zbatimin e Programit të Transparencës të Rishikuar, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, me urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020.

2. Zbatimin e Regjistrisë të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, me urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME  
Igli Hasani

#### URDHËR

Nr. 317, datë 13.9.2023

#### PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME NË PROCESAT GJYQËSORE

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së", ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", nenet 22 e vijues, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

#### URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për përfaqësimin ligjor të institucionit në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të nëpunësit/ve që do të përfaqësojnë institucionin.

3. Përfaqësuesi/t i/e autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara gjykatave, prokurorisë, zyrave të përmbarimit gjyqësor, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

4. Të gjitha aktet e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij urdhri dhe që janë nxjerrë në zbatim të



urdhrit nr. 30, datë 15.02.2022, “Për delegim kompetencash”, pika “a”, e urdhrit të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 13, datë 16.1.2023, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME  
**Igli Hasani**

**URDHËR**  
**Nr. 581, datë 28.9.2023**

**PËR HEQJEN E LICENCËS SË  
SHOQATËS “F.M.A.A.” SI AGJENCI E  
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË  
DREJTAVE TË AUTORËVE NË  
FUSHËN E KINEMATOGRAFISË DHE  
TË VEPRAVE TË TJERA  
AUDIOVIZUALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 159, pika 5, nenit 159/1, pika 2, shkronjat “a”, “c” dhe “d”, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, si dhe kreut II, ndarja “B”, të udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, të ministrit të Kulturës “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar”, bazuar në raportin nr. 1623/6 prot., datë 2.6.2023, të Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, për mbikëqyrjen financiare dhe administrative të agjencisë “F.M.A.A.” për vitin financiar 2022 dhe raportit nr. 4112/2, datë 18.9.2023, të grupit të punës sipas urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 480, datë 31.07.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për zhvillimin e hetimit administrativ si pjesë e procedurës administrative, të nisur

kryesisht ndaj Agjencisë së Administrimit Kolektiv “F.M.A.A.”,

**KONSTATOJ:**

Me urdhrin nr. 480, datë 31.7.2023, të ministrit të Kulturës, pas shkeljeve të konstatuara nga Drejtoria për të Drejtat e Autorit, në raportin nr. 1623/6 prot., datë 2.6.2023, është ngritur grupi i punës për zhvillimin e hetimit administrativ si pjesë e procedurës administrative, të nisur kryesisht ndaj “F.M.A.A.” si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat e autorit, konkretisht kreu II, ndarja “B”, pika 2, e udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, të ministrit të Kulturës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës administrative, rezulton se fillimi i hetimit administrativ ka marrë shkas nga shkeljet e konstatuara nga Drejtoria për të Drejtat e Autorit gjatë mbikëqyrjes së veprimtarive të agjencive të administrimit kolektiv dhe Sportelit unik për vitin 2022.

Mbikëqyrja për agjencitë është kryer në zbatim të nenit 159, të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, sipas të cilit DDA-ja kryen kontrollin e aktivitetit të tyre një herë në vit, duke i njoftuar 10 (dhjetë) ditë përpara. Mbikëqyrja është kryer në bazë të dokumentacionit të përcjellë nga agjencitë, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar dhe urdhrit nr. 125, datë 1.3.2023, të ministrit të Kulturës “Për raportin vjetor të agjencive të administrimit kolektiv dhe Sportelit unik”.

Referuar rezultateve të raportit nr. 1623/6 prot., datë 2.6.2023, të DDA-së për mbikëqyrjen financiare dhe administrative të “F.M.A.A.” si agjenci e administrimit kolektiv për vitin financiar 2022, konstatohet se veprimtaria e “F.M.A.A.” nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe statutin e saj. Konkretisht, konstatohen shkelje të nenit 159/1, pika 2, shkronjat “a”, “c” dhe “d”, të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar.

Në këto kushte, sipas procedurës së parashikuar në nenin 159, pika 5, të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar dhe kreut II, ndarjes “B”, pikës 2, të udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, DDA-ja i ka propozuar ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit fillimin e procedurës për heqjen e licencës për “F.M.A.A.” si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit.



Me urdhrin nr. 480, datë 31.7.2023, ministri i Kulturës ka ngritur grupin e punës për zhvillimin e hetimit administrativ si pjesë e procedurës administrative, të nisur kryesisht ndaj “F.M.A.A.”.

Grupi i punës nëpërmjet shkresës nr. 4112 prot., datë 7.8.2023, ka njoftuar “F.M.A.A.” mbi ngritjen e grupit të punës me qëllim zhvillimin e hetimit administrativ, si dhe mbi të drejtën për paraqitjen në seancën dëgjimore, të datës 29.8.2023, ora 11:00, në ambientet e Ministrisë së Kulturës, në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”.

Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit gjatë procedurës së hetimit administrativ, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DDA-ja dhe materialit plotësues nga “F.M.A.A.”, grupi i punës ka konstatuar si vijon:

Së pari, “F.M.A.A.” ka nënshkruar kontratë me “Almus Music Management”, me objekt kalimin e të drejtave ekskluzive të publikimit, monetarizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to në *Youtube* dhe platforma të tjera në linjë.

Lidhur me këtë kontratë vlerësohet si më poshtë:

a) kontrata është nënshkruar në dhjetor të vitit 2020, por është përcjellë pranë DDA-së në muajin prill të vitit 2023. Kontrata është me afat vlefshmërie 1 (një) vit, por sipas deklarimeve të kësaj agjencie, ajo ka përfituar të ardhura edhe pas këtij afati;

b) referuar nenit 138, të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, me ngritjen e Sportelit Unik asnjë agjenci e administrimit kolektiv nuk mund të kryejë individualisht funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit;

c) referuar nenit 137, të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, AAK-të, lidhin kontrata për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura vetëm në formë joekskluzive.

Së dyti, referuar bilancit vjetor të përcjellë nga “F.M.A.A.”, vlera e shpenzimeve në raport me shpërblimet e shpërndara është 102%, nga 30% që është parashikuar në pikën 5, të nenit 151, të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar.

Gjatë seancës dëgjimore grupi i punës konstatoi se për hartimin e bilancit vjetor të vitit financiar 2022, nuk është marrë miratimi i Asamblesë së Përgjithshme, në kundërshtim me statutin e agjencisë. Dokumentacioni provohet të jetë autorizuar nga drejtori ekzekutiv.

Së treti, në lidhje me vendimmarrjen e Bordit Drejtues, konstatohet si vijon:

a) vendimmarrja e Bordit Drejtues për shpërndarjen e të ardhurave tek anëtarët e agjencisë është në kundërshtim me statutin e agjencisë. Në pikën 4, të nenit 9, të statutit parashikohet se Bordi drejtues ka kompetencën të përcaktojë masën dhe mënyrën e derdhjes së kuotizacionit vjetor të anëtarëve dhe t’ia dërgojë për miratim Asamblesë së Përgjithshme. Sipas statutit propozimi bëhet nga Bordi dhe miratimi nga Asambleja;

b) sipas parashikimeve të statutit Bordi Drejtues duhet të mbledhet jo më pak se 4 herë në vit, ndërsa për vitin 2022 është mbledhur vetëm 1 herë;

c) dokumentacioni që i referohet vendimeve të Bordit është depozituar fillimisht i pa firmosur nga të gjithë anëtarët dhe pas ri depozitimit është përcjellë i firmosur.

Së katërti, “F.M.A.A.” ka shpërndarë të ardhura për 102 anëtarë nga 146 anëtarë që ka të publikuar në faqen zyrtare.

Së pesti, gjendja e llogarisë financiare të “F.M.A.A.” në fund të vitit 2022 rezulton në vlerën 4,480,956.29 (katër milionë e katërqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e nëntë) lekë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 151, pika 9, të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, sipas të cilit “tarifat e shpërblimeve të mbledhura nga përdoruesit, të cilat në përfundim të vitit financiar nuk shpërndahen nga AAK-ja, depozitohen në një fond special për llogari të ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit, në dispozicion të titullarëve të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për një periudhë 3-vjeçare”.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e “F.M.A.A.” janë shprehur se gjendja në llogarinë bankare është si rezultat i të ardhurave nga kontrata me “Almus Music Management” dhe të ardhurat e pashpërndara për anëtarët që ndodhen jashtë vendit.

Së gjashti, “F.M.A.A.” nuk ka përmbushur detyrimet e nenit 153, të ligjit nr. 35/2016, i ndryshuar, sipas të cilit agjencia ka detyrimin e publikimit të informacionit në faqen e saj të internetit. Nga konstatimi rezulton se në faqen zyrtare nuk është publikuar i gjithë informacioni i kërkuar, por vetëm statuti dhe lista e anëtarëve të organeve qendrore dhe vendore të administrimit, përbërjen e komisioneve të brendshme dhe listën e administratorëve lokal.

Për sa më sipër, në përfundim të procedurës së hetimit administrativ, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove në veçanti dhe të gjitha



provave në tërësi, grupi i punës konstaton se, veprimtaria e “F.M.A.A.” për vitin 2022, nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së shoqatës “F.M.A.A.” si “Agjenci e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve në fushën e Kinematografisë dhe të veprave të tjera Audiovizuale Forumi i Mbrojtjes së Producentëve dhe Autorëve – Film & Video” - “FMAA” në administrimin kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale.

2. Shoqata “F.M.A.A.” humbet të drejtën të ushtrojë funksionet si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorëve për të cilat është licencuar.

3. Shoqata “F.M.A.A.” humbet të drejtën si agjenci e administrimit kolektiv për aplikim për pajisje me licencë për një periudhë 3 (tre) vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Ndaj këtij urdhri, shoqata “F.M.A.A.” mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit të tij.

5. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

6. Ngarkohet Sporteli Unik, që kryen shërbimet për funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërbimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave në administrimin kolektiv, të mbrojtura nga të gjitha agjencitë e administrimit kolektiv të licencuara dhe shoqata “F.M.A.A.” për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS  
**Elva Margariti**

## VENDIM

Nr. 115, datë 30.3.2023

### MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË “KODIN E RRJETIT TAP” PROPOZUAR NGA TAP AG

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 13, 15, pika 1, germa “a”, 16, pika 24, dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; dispozitave të “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët” të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përrjashtimit të TAP AG, datë 6 qershor 2013, lëshuar nga autoritetet, sipas direktivës 2009/73/EC (Opinionit Përfundimtar i Përbashkët), të opinionit 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013, si dhe të neneve 15 dhe 26 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror “Mbi miratimin e një ndryshimi në “Kodin e Rrjetit TAP”, i propozuar nga TAP AG më 13 mars 2023”,

konstatoi se:

- TAP AG, me datë 1.9.2011, paraqiti në ERE, “Aplikimin e Përrjashtimit për Gazsjellësin Trans Adriatik”, në përputhje me nenin 22 të direktivës së gazit 2003/55/EC.

- Në muajin qershor 2013, Ministria Italiane, Autoriteti Rregullator Grek (RAE) dhe ERE, morën vendimin për përjashtimin nga dispozitat e nenit 9, 32, Aksesi i Palëve të Treta (TPA) dhe nenet 41.6, 41.8, 41.10 (Tarifat e Rregulluara) të Direktivës së Gazit për Kapacitetin Fillestar prej 10 miliardë metrash kub në vit, sipas disa kushteve, duke përshtatur Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (këtu dhe më poshtë “FJO”), një dokument i hartuar së bashku nga ARERA, ERE dhe RAE (këtu dhe më poshtë “Autoritetet”) dhe ndryshuar për t’u përputhur me vendimin e Komisionit (C(2013)2949 përfundimtar) datë 16 maj 2013, duke konsideruar: Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s:

- Opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të datës 14 maj 2013;

- Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian, të datës 13 korrik 2009;



- Direktivën e BE 2019/692 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 17 prill 2019;
- Rregulloren 715/2009/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 13 korrik 2009, i ndryshuar me vendimin e Komisionit Evropian, të datës 24 gusht 2012 (Rregullorja e CMP-së);
- Rregulloren e BE-së 312/2014 të Komisionit, të datës 26 mars 2014;
- Rregulloren e BE-së 2017/459 të Komisionit, të datës 16 mars 2017;
- Rregulloren e 2019/942/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 5 qershor 2019;
- Rregulloren e BE-së 2022/2576 të Këshillit, të datës 19 dhjetor 2022 (Rregullorja 2022/2576);
- Vendimin e Komisionit Evropian të datës 16 maj 2013, që përmban “Përjashtimin e TAP-it nga kërkesat për akses të palëve të treta, tarifa rregullimi dhe ndarja e pronësisë të përcaktuara në nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të direktivës 2009/73/KE” (vendimi i komisionit të datës 16 maj 2013).
- Me shkresën e datës 13 mars 2023 (TAP: LT-TAP-NRA-00049), TAP AG u ka kërkuar autoriteteve miratimin e ndryshimeve të Kodit të Rrjetit TAP (INC), siç përcaktohet te vendimi përfundimtar i tregtarëve/furnizuesve dhe shtojcave të tij, sipas pikave më poshtë:
  - zbatimi i mekanizmit të sigurt “përdore ose humbe” i ditës në avancë;
  - përditësim i procedurës së prokurimit të gazit;
  - përditësim i procedurës së prokurimit të gazit të pa llogaritur (që nuk merret parasysht *unaccounted-for gas*).
- TAP AG po ashtu u dërgoi autoriteteve rregullatore analizën sipas nenit 14(7) të rregullores 2022/2576 mbi ndikimet e mundshme të përfshirjes së mekanizmit të përcaktuar në nenin 14 (paragrafët 1–6).
- Duke vlerësuar se, Kodi i propozuar i Rrjetit i TAP-it, përputhet me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (FJO), me rregulloret e BE-së, në përgjithësi ato në lidhje me Procedurat e Menaxhimit të Kapacitetit (CMP) dhe me nenin 14 të Rregullores së Këshillit 2022/2576 BE.
- Në TAP NC, ndër të tjera ka një angazhim nga kompania TAP AG (shtojca 5 e TNC-së) për të përditësuar dhe për të integruar TNC-në, sapo të ketë filluar aktiviteti tregtar, veçanërisht në pjesët që kërkojnë fitimin e përvojës operationale.
- Shtojca 5 parashikon në pikën 1, se TAP AG duhet të përfshijë në TNC një mekanizëm

- afatshkurtër të zgjidhjes së kongestionit mbi abonimin dhe mekanizmin e blerjes, përdorimit ose humbjes së ditës përpara (FDA UIOLI), në zbatim të neneve 2.2.2 ose 2.2.3 të aneksit I të rregullores së CMP. Referuar pikës 1 të shtojcës 5, një mekanizëm që parashikon kufizimin e së drejtës së riemërtimit për përdoruesit që përdorin pak kapacitetin që kanë:
  - palët e interesuara: ata që mbajnë më shumë se 10% të kapacitetit në dispozicion në vitin e kaluar termik;
  - periudha e monitorimit: periudha e barabartë me një vit, në të cilën gjendja e “ngjeshur kontraktuale”;
  - mbingarkesë kontraktuale: e përcaktuar në mënyrë alternative.
- Autoritetet vlerësojnë se periudha e monitorimit për FDA UIOLI duhet të zvogëlohet me një muaj ose me pak për të qenë më efektive në zgjidhjen e kongestionëve kontraktuale të mundshme që shfaqen në një periudhë afatshkurtër. Për sa kohë është e përfshirë rregullorja 2022/2576, zbatimi i nenit 14 (paragrafët 1–6) të sistemi i TAP-it nuk pritet që të ketë përfitime.
- Rregullorja 2022/2576 ka hyrë në fuqi më 30 dhjetor 2022 dhe ka një kohëzgjatje të përkohshme për një vit. Neni 14 zbatohet nga 31 marsi 2023, neni 14 u jep autoriteteve rregullatore kombëtare të drejtën për të vendosur zbatimin nga shoqëritë e transportit të njërit prej mekanizmave alternativë të renditura në nenin 14(7), duke përfshirë FDA UIOLI.
- Në lidhje me sa më sipër, derogimi, sipas nenit 14(7)(a) i rregullores 2022/2576 mund të aplikohet te pikat e interkoneksionit të TAP-it. Vlerësohet i nevojshëm miratimi i këtij ndryshimi në “Kodin e Rrjetit TAP” – propozuar nga TAP AG dhe bashkangjitur si aneksi B, ndërkohë që ky dokumenti i përbashkët është miratuar, gjithashtu, edhe nga rregullatorët e Italisë dhe Greqisë (ARERA dhe RAE).

#### VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi propozuar nga TAP AG, cilësuar si aneksi A, në “Kodin e Rrjetit TAP” dhe bashkangjitur ndryshimet të cilësuar si aneksa B (bashkëlidhur).
2. Versioni në gjuhën anglisht ka përparësi nga varianti në gjuhën shqipe në interpretim nga palët.



3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët TAP AG, SRG dhe DESFA për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**



*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8
-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë